

**UNITED NATIONS**  
**United Nations Interim**  
**Administration Mission**  
**in Kosovo**



**NATIONS UNIES**  
**Mission**  
**d'Administration**  
**Intérimaire des Nations**  
**Unies au Kosovo**

**PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT**

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

**Legjislacioni -III**

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi  
Mbledhja nr. 02-2008  
Prishtinë, me 12 shkurt 2008, ora 13:10  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C- 203

**PROCESVERBAL**

i mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni, Adem Salihaj, Ramadan Gashi, Selvije Halimi, Kolë Berisha, Riza Smaka, Bajram Kosumi, Adem Hajdaraj.

**Munguan:** Branisllav Grbiq, Melihate Tërmkolli, Džezair Murati.

**Të ftuarit:** Ramadan Islami - monitorues i OSBE-së, Lejla Selimi – monitorues i OSBE-së, Reshit Gashi - NDI.

**Nga stafi i komisionit:** Idriz Tahiri-zyrtar i lartë ligjor, Drita Çarkaxhiu-zyrtare ligjore, Behlul Zeka-zyrtar ligjor, Sulltane Gashi-asistente administrative.

Mbledhjen e kryesoi Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit, me këtë:

**REND DITE**

1. Miratimi i rendit të ditës;
  2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;
  3. Shqyrtimi në parim i P/ligjit për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2008
  4. Shqyrtimi i propozimit të fushëveprimit të Komisionit;
  5. Formimi i grupeve të punës për hartimin e Planit të punës për vitin 2008 dhe për hartimin e rregullave të punës së Komisionit;
  6. Të ndryshme;
- Njoftim për Memorandumin e bashkëpunimit ndërmjet Komisionit dhe NDI-së

## 1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari i njoftoi të pranishmit për propozimin e rendit të ditës.

*Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.*

## 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

**Kryetari** në fillim i përshëndeti anëtarët e Komisionit dhe të pranishmit e tjerë, pastaj i pyeti anëtarët për vërejtje eventuale për procesverbalin.

*Procesverbali u miratua pa vërejtje.*

## 3. Shqyrtimi në parim i P/ligjit për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2008

**Bahri Hyseni**-kryetar i Komisionit, theksoi se ka marrë pjesë në një takim të përbashkët të kryetarëve të komisioneve me kryetarin e Kuvendit dhe janë pajtuar të punohet me një procedurë më të shpejtë të miratimit të këtij projektligji, mundësisht para datës 28, sepse nëse nuk miratohet para kësaj date, atëherë do ta miratojë Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP). Ai më tutje shtoi se të premten do të ketë seancë dhe njëra nga pikat e rendit të ditës do të jetë buxheti. Ne duhet shikuar a ka bazë ligjore ky projektligj.

Kryetari, gjithashtu, prezantoi edhe dy kërkesa, njëra e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe tjetra e Institutit Gjyqësor të Kosovës, në të cilat kërkohet rritje e buxhetit. Këto kërkesa janë pranuar me vonesë, vetëm sot në orën 10:00. Kryetari, më tutje, shtoi se ka informata nga Komisioni për Buxhet dhe Financa se në këtë drejtim nuk ka mundësi të lëvizet shumë. Një mundësi do të ishte të merren parasysh këto kërkesa gjatë rishikimit 6- mujor të buxhetit. Ai theksoi se në këtë takim ishte i pranishëm edhe përfaqësuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës që pyeti për mundësinë që edhe ai t'i prezantojë shqetësimet e KGJK-së.

**Bajram Kosumi**-theksoi se meqë kemi një kërkesë për procedurë të përshpejtuar, ne duhet të hapim debat rreth Projektligjit për Buxhet në mënyrë që rekomandimi të mos jetë i përpiluar vetëm me një fjali. Ai u pajtua të dëgjohet përfaqësuesi i KGJK-së, në mënyrë që të vazhdohet më tutje.

**Selvije Halimi**-theksoi se ne tash nuk duhet të merremi me këtë kërkesë të KGJK-së, pasi që nga ne nuk pritet të bëjmë ndryshime. Një rishikim pritet të bëhet ndoshta në muajin qershor. Ajo më tutje shtoi se është shumë vështirë të bëhen lëvizje në këtë buxhet.

**Bajram Kosumi**-konstatoi edhe një herë se duhet të debatohet për Projektligjin, ngase duhet përgatitur edhe rekomandimin, prandaj ne këtu duhet të debatojmë.

**Riza Smaka** - theksoi se gjykatësit dhe prokurorët konsiderohen shërbyes civilë dhe se duhet të bëhet një sistemim i pagave të nëpunësve civilë. Ai potencoi se këtu duhet të merret gjithmonë parasysh përgjegjësia, puna me palë dhe se është e rëndësishme të gjendet baza sipas kualifikimeve. Ai shtoi se ne jemi në favor të tyre, por këtë duhet trajtuar parimisht dhe të gjejmë një zgjidhje.

**Kryetari**-në vazhdim ia dha fjalën Vehbi Behlulit, përfaqësues i KGJK-së, zyrtar për buxhet dhe financa në Sekretariatit e KGJK-së.

**Vehbi Behuli**-theksoi se KGJK-ja është themeluar në bazë të Rregullores 2005/52, deri në vitin 2007 buxheti i gjyqësorit ka qenë i rezervuar në buxhetin e Departamentit të Drejtësisë, ndërsa

nga viti 2007 KGJK menaxhon buxhetin për të gjitha gjykatat e Kosovës dhe për Sekretariatit e KGJK-së që ka kod të veçantë buxhetor. Ai më tutje shtoi se janë gjithsej 59 gjykata të të gjitha niveleve në Kosovë dhe se ato janë drejtuar me kërkesa që nga fillimi, pra marsi i vitit 2007. Ai potencoi se rritja e numrit të lëndëve na detyron të kërkojmë rritje të buxhetit, pasi që duhen edhe 80 gjyqtarë të rinj. Duhet rritur numri i gjyqtarëve nga 322,sa janë paraparë me buxhet të vitit të kaluar në 402. Ai shtoi se 4, 124, 500 € mijë janë për mallra dhe shërbime dhe se ndarjet e deritashme kanë qenë në nivel. Një ndër çështjet shqetësuese është edhe kategoria e të dënuarve pa bazë, të cilëve u takon kompensimi për shkak të mbajtjes së tyre në burg dhe për shkak të mungesave buxhetore ne nuk kemi arritur ta bëjmë kompensimin. Në rast kur një person ka qëndruar 2-3 vjet në burg dhe duhet kompensuar deri 50 mijë € Ai në fund kërkoi që këto shqetësime të merren parasysh edhe nga Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe falënderoi të pranishmit për vëmendjen.

**Kryetari**-pyeti anëtarët nëse kanë ndonjë pyetje lidhur me këtë çështje.

**Riza Smaka** - u shpreh në lidhje me rastet e qëndrimit në burg për një kohë të gjatë. Ai theksoi së për raste të tilla duhet hartuar norma, pasi që gjyqtari duhet të këtë kujdes gjatë rasteve të tilla, sepse në një mënyrë ai bëhet debitor i buxhetit të Kosovës. Ai më tutje shtoi se ka dëgjuar për disa raste të tilla dhe se nuk e di sa janë gjithsej.

**Përfaqësuesi i KGJK-së e liroi sallën.**

**Adem Salihaj**-theksoi se ka përpara kërkesën e KGJK-së, të datës 08.05.2007, drejtuar Agim Krasniqit, drejtor i buxhetit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, por nuk ka ndonjë përgjigje nga MEF për këtë kërkesë. Ai më tutje shtoi se në raste të tilla duhet pasur një përgjigje apo mendim. Ai gjithashtu potencoi se herëve të tjera, kur ka të ftuar është më mirë që i ftuari të mos ftohet menjëherë në sallë, por të thirret në ndërkohë.

**Adem Hajdaraj**-u pajtua me mendimin e Adem Salihajt se një kërkesë e bërë më 08.05.2007, është dashur ta ketë edhe një përgjigje, pasi që ka kaluar një kohë mjaft e gjatë.

**Bajram Kosumi**-tha se KGJK bie brenda fushveprimit tonë dhe se ne duhet të japim një përgjigje. Duhet të flasim për paga dhe mëditje, sepse nëse dëshirojmë gjyqësor më stabil, ne duhet edhe 't'u krijojmë kushte dhe se gjyqtarët dhe prokurorët duhet të mbështeten. A i më tutje theksoi se 2 milionë janë shtesë për paga dhe mëditje, MEF te vija buxhetore mund t'i gjejë 2 milionë, siç i ka gjetur 8 milionë për AKM-në, nuk ka nevojë që AKM-së t'i rritet buxheti. Kemi një procedurë të përshpejtuar, por ne duhet të dalim me rekomandim dhe që MEF të shikojë në lidhje me këtë.

**Kryetari**-theksoi se janë dy kërkesa të paraqitura dhe u pajtua se kërkesat bien në fushëveprimin e Komisionit. Ai shtoi se ne mund ta bëjmë një rekomandim dhe të kërkojmë rritjen e pagave të gjyqtarëve dhe të prokurorëve. Gjithashtu ai u pajtua edhe për çështjen e thirrjes së të ftuarve, por herë të tjera do t'i ftojme në orë të caktuar, në pikën për të cilën janë thirrur.

**Riza Smaka**-potencoi se në rastet kur institucionet i neglizhojnë kërkesat e palëve, kemi afatet prekluzive që duhen respektuar. Në rastin tonë kemi kërkesën e bërë në muajin maj të vitit 2007, ndërsa nga ana e drejtorit të buxhetit në MEF, nuk i është dhënë asnjë përgjigje kësaj shkrese. Ne duhet të kërkojmë nga drejtori i buxhetit: Pse nuk i është dhënë përgjigje kësaj shkrese. Ai më tutje shtoi se gjithashtu duhet të kërkohet edhe nga Ministria e Shërbimeve Publike të punohet në një ligj për nivelizimin e pagave të shërbyesve civilë, duke përfshirë këtu gjyqtarët dhe prokurorët.

*Kryetari kërkoi që në lidhje me këtë çështje të hartohet një raport dhe u konstatua se ka bazë juridike për Projektligjin në fjalë.*

**Bajram Kosumi**-theksoi se këto kërkesa do të merren parasysh gjatë rishikimit të buxhetit. Kurse sa u përket pagave, për këtë vendos Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

**Selvije Halimi**-kujtoi se nëse dëshirojmë t'i shikojmë procedurat, atëherë duhet pyetur se kujt i janë drejtuar këto shkresa? Cilës adresë? Ajo më tutje theksoi se edhe pse këto shkresa janë në fushëveprimin tonë, nuk na janë drejtuar drejtpërsëdrejti. Nëse dëshirojmë t'i përmbahemi procedurës, atëherë këto shkresa nuk kanë ardhur në mënyrë të rregullt. Ajo shtoi se buxheti duhet të miratohet deri të hënën dhe se gjithashtu duhet të kërkohet nga Ministria e Shërbimeve Publike ta zbatojë planin për nivelizimin e pagave. Në fund, ajo tha se nuk di si t'u thotë – po këtyre dy kërkesave të ardhura.

**Kryetari**-sqaroi se mënyra e ardhjes së Projektligjit të Buxhetit në komisione është bërë me një procedurë të përshpejtuar në mënyrë që gjithçka të përfundohet para datës 28. Ai më tutje theksoi se ne duhet ta shikojmë bazën dhe të mos hyjmë në detaje, vetëm të rekomandojmë që gjatë rishikimit të dytë të buxhetit të realizohen edhe këto kërkesa.

**Adem Salihaj**-u pajtua me mendimin e Selvije Halimit se këto kërkesa nuk kanë ardhur drejtpërdrejt te ne dhe se Agim Krasniqi është dashur të na drejtohej në lidhje me këtë. Ai më tutje theksoi se çfarëdo shkrese që do të na vijë në të ardhmen, duhet ta ketë edhe një shkresë përcjellëse nga përgjegjësit dhe propozoi të bëhet një rekomandim në të cilin do të shkruhet: Të shqyrtohet mundësia e rritjes së buxhetit, pra jo domosdo, sepse ne mund të marrim shumë kërkesa nga ana e organizatave të ndryshme buxhetore që kërkojnë rritje të buxhetit.

**Kryetari**-theksoi se Komisioni për Buxhet dhe Financa ka marrë shumë kërkesa nga organizata të ndryshme buxhetore, por varësisht nga fushëveprimi ato u janë dërguar komisioneve përkatëse. Ai më tutje konstatoi se ka pajtim për ta bërë rekomandimin dhe ia dha fjalën drejtorit të Departamentit Ligjor, Daut Beqiri, për t'i bërë disa sqarime procedurale.

**Daut Beqiri**-u shpreh se sa i përket Projektligjit për Buxhetin, kjo është një procedurë e veçantë, ndërsa Rekomandimi nga Komisioni për Legjislacion i drejtohet Komisionit për Buxhet që do të vendosë për ta miratuar. Ndërsa më tutje shtoi se miratimi i Projektligjit varet nga mënyra që do të aplikohet. Kuvendi me 2/3 vendos për shmangien nga rregullat e Rregullores. Ai theksoi se është shumë mirë që po debatohet për këtë paraprakisht.

*Komisioni pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, njëzëshëm u pajtua që Rekomandimi të theksojë rishikimin e dytë të Buxhetit.*

#### **4. Shqyrtimi i propozimit të fushëveprimit të Komisionit;**

**Kryetari**-theksoi se Komisioni ka pësuar ndryshime dhe tashti ne na duhet t'i identifikojmë përgjegjësitë. Ai hapi diskutimin në lidhje me propozimin për fushëveprim.

**Bajram Kosumi**-u pajtua në parim për këtë, por gjithashtu paraqiti edhe disa vërejtje në lidhje me të shprehurit.

Vërejtja e parë është se duhet ndryshuar viza e tretë në propozimin e fushëveprimit, e cila thotë, si vijon:

- *“Shqyrton të drejtën e Kuvendit për të miratuar deklarata politike, rezoluta dhe akte të tjera nënligjore nga fushëveprimi i Kuvendit”*

Ndryshimi që duhet bërë është:

- **Shqyrton deklarata politike, rezoluta dhe akte të tjera nënligjore në miratim nga Kuvendi i Kosovës nga aspekti i kushtetutshmërisë së tyre.**

Gjithashtu duhet të ndryshohet edhe viza katër:

- *“Përcjell dhe shqyrton zbatimin e Kushtetutës”*

Ai theksoi se duhet hequr këtë, sepse kjo është prerogativë e Gjykatës Kushtetuese.

Po ashtu edhe viza e shtatë me radhë duhet të riformulohet.

- *“Jep propozime për ndryshimin e ligjeve me qëllim të harmonizimit të tyre”*

Kjo është e pasaktësuar dhe duhet bërë:

- **I kërkon Qeverisë amendamentimin e ligjeve me qëllim të harmonizimit me legjislacionin tjetër e në raste të veçanta edhe vetë amendamenton ligjet për këtë qëllim.**

Kurse te viza e fundit në faqen e parë e cila thotë:

- *“Jep mendimin për pajtueshmërinë e legjislacionit vendor me standardet evropiane”*

**Bajram Kosumi**-theksoi se kjo duhet të hiqet krejt, sepse kjo është kompetencë e Komisioni për Integritet Evropiane, ndërsa theksoi se duhet të shtohet një pikë e re në faqen e dytë:

-**Mbikëqyr zbatueshmërinë e ligjeve në fushën e gjyqësisë në përgjithësi.**

Po ashtu në faqen e dytë të propozimit të fushëveprimit, viza e parë, e dyta dhe e treta duhen formuluar ndryshe.

- *“Shqyrton çështjen e angazhimit të ekspertëve”*

Duhet bërë:

-**Angazhon ekspertë**

- *“Shqyrton çështjen e organizimit të dëgjimeve publike”*

Duhet bërë:

-**Organizon dëgjime**

- *“Shqyrton mundësinë e formimit të grupeve”*

Duhet bërë:

-**Formon grupe**

**Adem Hajdaraj**-u pajtua me vërejtjet e paraqitura nga Bajram Kosumi dhe gjithashtu paraqiti një vërejtje në lidhje me vizën e fundit të faqes së dytë, e cila thotë:

- *“Vënë kontakte të përhershme me komisionet tjera të Kuvendit....”*

Ai theksoi se nuk bën të thuhet “vënë kontakte”, kjo duhet të ndryshohet me “kontakton”.

**Selvije Halimi**-propozoi që viza e parë e propozimit të fshihet, sepse është Kuvendi ai që i cakton detyrat. Gjithashtu edhe viza që flet për kushtetutën të fshihet ,sepse do të kemi Gjykatën Kushtetuese që do të m'erret me këtë. Më tutje ajo shtoi se ky dokument duhet të analizohet edhe më tepër nga ne, pasi që është vetëm një propozim. Ajo shtoi se duhet t'i shikojmë edhe fushëveprimet e komisioneve të tjera dhe mbetet që ne t'i mbikëqyrim ligjet të cilat janë në sferën tonë.

**Riza Smaka**-theksoi se pajtohet me vlerësimet e kolegëve dhe propozoi që në fushëveprim të përmbajë edhe këto dy pika:

- Analizon dhe vlerëson përshtatshmërinë e akteve të cilat i miraton Kuvendi i Kosovës me kushtetutën dhe kur konkludon, Kuvendit të Kosovës përkatësisht sponsoruesit të aktit i propozon zgjidhje juridike konform me parimin e konstitucionalizmit dhe të legalitetit.
- Në raste të caktuara përcakton propozimligjin, amendament në ligj ose në aktin të cilin e miraton Kuvendi i Kosovës.

**Kryetari**-theksoi se rekomandimet ishin me vend dhe se në mbledhjen e ardhshme do ta sjellim për shqyrtim propozimin. Ai më tutje kërkoi që ky propozim të miratohet në parim, pastaj zyrtarët e administratës do ta vendosin në letër.

*Propozimi u miratua njëzëshëm.*

## **5. Formimi i grupeve të punës për hartimin e Planit të punës për vitin 2008 dhe për hartimin e rregullave të punës së Komisionit;**

**Kryetari**-theksoi se duhet ta bëjmë një plan të punës që do t'i përmbante dëgjimet publike si dhe aktivitetet e tjera. Ai më tutje shtoi se janë dy mënyra për ta bërë këtë: e para që ta krijojmë një grup pune që i do të punonte për këtë plan së bashku me organizatat të cilat e mbështesin Komisionin dhe mënyra e dytë që kryetari së bashku me dy zëvendëskryetarët të punojnë për një plan.

**Riza Smaka**-propozoi të shkohet me mënyrën e dytë. Kështu që kryetari dhe dy zëvendëskryetarët të punojnë së bashku me zyrtarët e administratës për të bërë një plan 2 deri në 3 faqe.

**Bajram Kosumi**-u pajtua që ky plan të propozohet nga ky grup, pastaj do të miratohej edhe në Komision.

**Adem Salihaj**-propozoi që plani fillestar i këtij drafti t'u dërgohet me mënyrë elektronike edhe anëtarëve të tjerë të Komisionit.

*Pas diskutimit në lidhje me Planin e punës. Komisioni vendosi që kryetari së bashku me dy zëvendëskryetarët dhe zyrtarët e administratës, ta hartojnë planin e punës.*

**Kryetari**-gjithashtu ngriti edhe çështjen e Rregullores së Punës së Komisioneve. Ai theksoi se NDI-ja ka bërë një draft për të gjitha komisionet e Kuvendit dhe pyeti anëtarët nëse janë të pajtimit të themelohet edhe një grup pune në lidhje me rregullat e punës së Komisionit.

**Riza Smaka**-konstatoi se do të ishte më mirë që secili nga anëtarët ta merrte këtë draft të NDI-së, për ta lexuar dhe më pastaj edhe për ta shqyrtuar.

**Kryetari**-u pajtua dhe propozoi që pasi të merret drafti për shqyrtim do të mund të caktohet edhe një referues.

*Propozimi u miratua njëzëshëm*

**6. Të ndryshme;**

**- Njoftim për Memorandumin e bashkpunimit ndërmjet Komisionit dhe NDI-së**

**Kryetari**-i njoftoi anëtarët në lidhje me Memorandumin e Bashkëpunimit që është nënshkruar nga secili kryetar i komisionit. Përmes këtij memorandumi, NDI-ja do të mbështetë Komisionin edhe për këtë vit. Anëtarët e Komisionit u njoftuan edhe për propozimin e mbajtjes së një tryeze të rumbullakët nga OSBE, në të cilën do të prezantonin edhe disa nga anëtarët e tashëm të Komisionit.

**U vendos që kjo tryezë të mbahet në fundi të javës së ardhshme.**

**Kryetari i falënderoi edhe një herë të pranishmit dhe e deklaroi mbledhjen të mbyllur.**

Behlul Zeka  
Zyrtar ligjor

**Kryetari**

---

Bahri Hyseni